



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2499, datë 17.09.2014

Për

Miratimin e dokumentit për këshillim publik “Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren nr. 2 datë 21.02.2008 për “Rregjistrimin dhe Administrimin e Emrave të Domain-eve nën .al dhe nëndomain-et gov.al, mil.al edu.al, com.al, org.al, dhe net. al e ndryshuar”.

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

| | | |
|----------------|------------|---------|
| 1. Z. Piro | Xhixho | Kryetar |
| 2. Z. Alban | Karapici | Anëtar |
| 3. Znj. Alketa | Mukavelati | Anëtar |
| 4. Z. Benon | Paloka | Anëtar |
| 5. Znj. Zamira | Nurçe | Anëtar |

dhe sekretare Znj.Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 17.09.2014, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, shqyrtoi çështjen me objekt:

Miratimin e dokumentit për këshillim publik “Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren nr. 2 datë 21.02.2008 për “Rregjistrimin dhe Administrimin e Emrave të Domain-eve nën .al dhe nëndomain-et gov.al, mil.al edu.al, com.al, org.al, dhe net. al, e ndryshuar.

BAZA LIGJORE:

- 1) Neni 127, 128 i Ligjit Nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative”.
- 2) Gërma k) dhe p) e nenit 8, neni 110, neni 114, neni 115 i Ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (**ligji nr. 9918**)
- 3) Ligji nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”;

- 4) Udhëzuesi “Për procedurat e Këshillimit Publik” miratuar me Vendim nr.1183, datë 10.03.2010 të Këshillit Drejtues të AKEP,

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Relacioni shoqërues i Projekt-Vendimit (*Relacioni*),
2. Projekt akti “Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren nr. 2 datë 21.02.2008 për “ Rregjistrimin dhe Administrimin e Emrave të Domain-eve nën .al dhe nëndomain-et gov.al, mil.al edu.al, com.al, org.al, dhe net. al , e ndryshuar (Përmbajtja)
3. Projekt Vendimi i formatuar dhe arsyetuar;
4. Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, dhe bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

AKEP , sipas shkronjës k) të nenit 8 të ligjit nr.9918 është Autoriteti kompetent që administron domain ccTLD.al, nëndomain-et e tij , si dhe ENUM.

Shtesat dhe ndryshimet e propozuara përmirësojnë ndjeshëm si anën formale të Rregullores ashtu dhe rregullat në përmbajtje të saj, të cilat janë të nevojshme me qëllim reflektimin e disa ndryshimeve të domosdoshme në kuadër të masave për liberalizimin e mëtejshëm të rregullave për rregjistrimin dhe administrimin e emrave të domain-eve nën .al dhe nëndomain-et gov.al, mil.al edu.al, com.al, org.al, dhe net. al

Dokumenti “Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren nr. 2 datë 21.02.2008 për Rregjistrimin dhe Administrimin e Emrave të Domain-eve nën .al dhe nëndomain-et gov.al, mil.al edu.al, com.al, org.al, dhe net. al”, e ndryshuar është përgatitur në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor përkatës duke patur parasysh dhe duke implementuar objektivat rregullator të AKEP.

PËR KËTO ARSYE:

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e miratimit të dokumentit të cituar më lart, bazuar në nenin 114, dhe në nenin 115 të ligjit nr. 9918 i ndryshuar, Këshilli Drejtues i AKEP,

V E N D O S:

1. Të miratojë për këshillim publik dokumentin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren nr. 2 datë 21.02.2008 për “Rregjistrimin dhe Administrimin e Emrave të Domain-eve nën .al dhe nëndomain-et gov.al, mil.al edu.al, com.al, org.al, dhe net. al e ndryshuar, sipas dokumentit bashkëlidhur”.
2. Periudha e këshillimit publik fillon nga data e publikimit të dokumentit në faqen elektronike të AKEP dhe është 30 ditë.
3. Ky Vendim të publikohet në faqen e Internetit të AKEP www.akep.al.

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARË:

1. **Alban KARAPICI**
2. **Alketa MUKAVELATI**
3. **Benon PALOKA**
4. **Zamira NURÇE**



AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLOREN NR. 2, DATË 21.02.2008 “ PËR REGJISTRIMIN DHE ADMINISTRIMIN E EMRAVE TË DOMAIN-EVE NËN.AL DHE NËN DOMAIN-ET .GOV.AL, MIL.AL, EDU.AL, COM.AL, ORG .AL DHE NET.AL, E NDRYSHUAR.

**Dokument për Këshillim Publik
Shtator, 2014**

(Miratuar me VKD 2499 datë 17.09.2014)

PUBLIKUAR NE SEKSIONIN KONSULTIME NE PROCES WWW.AKEP.AL

Disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren nr. 2 datë 21.02.2008 për “Rregjistrimin dhe Administrimin e Emrave të Domain-eve nën .al dhe nëndomain-et gov.al, mil.al edu.al, com.al, org.al, dhe net. al e ndryshuar”.

1. Shfuqizimin e nenit 20.2 gërma b).
2. Në nenin 27 të Rregullores pas gërmës b) të shtohet një paragraf i ri e të gërmëzohet si c) me përmbajtje si më poshtë vijon: World Intellectual Property Organization -WIPO- (Arbitration and Mediation Center).
(Referim sipas rregullave të përcaktuara në dokumentin bashkëlidhur).
3. Në Aneksin 1, pika 10 pas gërmës e) të shtohet një paragraf i ri me përmbajtje si: “Transferimi i një domain-i nga Regjistruesi AKEP te cilido regjistrues tjetër është pa pagesë dhe regjistruesi pritës nuk kreditohet dhe të gërmëzohet si 10 f) ndërkohë që gërma f) aktuale të bëhet g).
4. Referuar Aneksit 1, Tabelës nr. 3 Pagesat për regjistrimin e domain cc. TLD nga Regjistruesit ,tek pika c) togfjaleshi “Cmimi i 1 (një) krediti për regjistruesit eshte 600 lekë” të zëvendësohet me “Cmimi i 1 (një) krediti për regjistruesit është 300 lekë”.
5. Pas pikës c) të shtohet një pikë tjetër e cila të gërmëzohet pika d) me përmbajtje si më poshtë vijon:

Tabela nr.3 Aneksi nr.1

Pagesat për regjistrimin e domain cc. TLD nga Regjistruesit

Pagesat që Regjistruesit duhet të kryejnë në AKEP, të jenë si më poshtë:

| |
|---|
| a. Vlera e Akreditimit, për çdo subjekt që kërkon të veprojë si regjistrues 20 000 Lekë (pagesë e cila kryhet vetëm një herë të vetme); |
| b. Pagesa vjetore, që çdo subjekt i akredituar duhet të depozitojë për AKEP në mënyrë që të veprojë si Regjistrues 100 000 Lekë; |
| c. Cmimi i 1 (një) krediti për Regjistruesit është 300 lekë |
| d. Pagesa e rregjistrimit të domain pranë AKEP është 5000 lekë për 5 (pesë) vjet. |